

V E N D I M
Nr. 398, datë 27.7.2000

**PËR PËRJASHTIM TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE NGA PAGESAT E
PRAPAMBETURA TË QIRASË SË TOKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 7, të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jo bankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, dhe neni 6, pika 1 e ligjit nr.8360 me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Qiratë e papaguara të tokës që shoqëritë huamarrëse, për asete në pronësi sipas lidhjes bashkëlidhur, kanë me kontrata, me këshillat e komunave apo bashkive, nuk janë pjesë e skemës së shpërndarjes së vlerave financiare, dhe si të tilla nuk shlyhen nga administratorët.

2. Me shitjen e aseteve në pronësi të shoqërive huamarrëse, dhe transkriptimin e pronësisë, qiraja e tokës paguhet nga blerësit e rinj.

Llogaritja e qirasë së tokës fillon me lidhjen e kontratës me këshillin e komunës apo të bashkisë dhe vazhdon deri në privatizimin e saj.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal, Grupi Mbikëqyrës dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**SIPËRFAQET E TROJEVE TË OBJEKTEVE NË PRONËSI TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE,
PËR TË CILAT NUK PAGUHET QERAJA E PRAPAMBETUR**

Nr.	Objektet	Shoqëria në administrim	Sip. e tokës me qira m2
1.	Pularia Yzberisht	“Vefa Hollding”	16 000
2.	Kompleksi i Derrit Paskuqan	“Vefa Hollding”	44 480
3.	Kombinati i therrjes së Shpendëve në Tiranë	“Vefa Hollding”	5 086
4.	Kompleksi i Shpendëve Paskuqan	“Vefa Hollding”	36 200
5.	Kompleksi i Pularisë së Vezëve Fier	“Vefa Hollding”	36 700
6.	Kompleksi i Gjelit të Detit Lushnje	“Vefa Hollding”	28 000
7.	Frigorifer Lushnje	“Vefa Hollding”	10 200
8.	Pularia Shushicë Elbasan	“Vefa Hollding”	69 700
9.	Fabrika e Vajit Himarë	“Vefa Hollding”	14 400
10.	Fabrika e Llokumeve Fier	“Vefa Hollding”	3 990
11.	Ndërtesa në Bukonik Elbasan	“Vefa Hollding”	1 340
12.	Ndërtesa në Gjinan Elbasan	“Vefa Hollding”	2 000
13.	Kabina dhe Bar-Bufë në Plazhin e Vlorës	“Vefa Hollding”	1 499
14.	Parku i Industrisë Vlorë	“Vefa Hollding”	7 580
15.	Magazinë Konservash Vlorë	“Vefa Hollding”	825
16.	Fabrika e Birrës Vlorë	“Cenaj&Co”	12 000
17.	Kompleksi i rritjes së derrit Akerni Vlorë	“Kamberi”	68 800
18.	Nyje e betonit	“Kamberi”	11 360
19.	Plazhi Kristal dhe i Palasës	“Kamberi”	5 500
		Shuma	375 660

